

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3.të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. B.J., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.264/2016 datë 21.6.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.403/2017 datë 22.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.4.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Sh.K., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.264/2016 datë 21.6.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.403/2017 datë 22.9.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.264/2016 datë 21.6.2016, i dënuari Sh.K., është shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3.të KPK-së dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 4.12.2015 e tutje. Me të njëjtin aktgjykim të dënuarit i është shqiptuar edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e kujdesit shëndetësor, ashtu që koha e kaluar në Institucion do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Shpenzimet e procedurës penale kanë mbetur barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.403/2017 datë 22.9.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. B.J. nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK-së dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i dënuari Sh.K. të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.7/2018 datë 30.1.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesë, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, në arsyetim të të njëjtës i referohet vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke pretenduar se me asnjë fakt nuk është vërtetuar se i dënuari ka kryer veprën për të cilën është shpallur fajtor. Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtësi konsideron se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje nga neni 384 par.1 pika1.12 të lidhur me nenin 370 të KPPK-së, ngase arsyetimi i aktgjykimit është i shkurtë dhe se nuk është arsyetuar se në cilat fakte është bazuar kur ka konstatuarës i dënuari është fajtor e sidomos me rastin e caktimit të dënimit. Si shkelje e Ligjit penal, mbrojtësi pretendon se meqë gabimisht është vërtetuar gjendja faktike si dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale ,sidomos me rastin e matjes së dënimit, meqë nuk janë aplikuar rrethanat lehtësuese dhe mos arsyetimi për këtë fakt, ka bërë që ndaj të dënuarit të shkelet ligji penal në dëm të tij. Më tutje, në kërkesë mbrojtësi i referohet edhe vendimit mbi sanksionin penal duke konsideruar se i njëjti është i lartë.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht si dhe i referohet edhe vendimit mbi sanksionin penal edhe pse me dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kjo nuk është e lejuar, andaj kjo gjykatë nuk i shqyrtoi këto pretendime.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në kërkesë, kjo gjykatë gjen se aktgjykimet e kundërshtuara kanë dispozitive të qarta, konkrete, të cilat nuk përmbajnë kundërthënie me vetveten e as me arsyetimin e tyre. Në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë janë paraqitur të gjitha elementet të cilat përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Kështu nga shkresat e çështjes, kjo gjykatë gjen se në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore të cilat i ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Në këtë aktgjykim janë dhënë fakte dhe arsye si dhe është bërë vlerësimi i provave konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK-së. Sa i përket fakteve vendimtare të cilat i pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, por edhe nga shkresat e

çështjes, kjo gjykatë gjen se nuk është kontestuese se natën kritike i dënuari Sh.K., ka qenë vetëm në shtëpinë e tij, në të cilën ka jetuar së bashku me gjyshin-tani të ndjerin I.K. dhe motrën e tij S.K., e cila natën kritike ka qenë në punë në ndërrimin e natës, deri në orën 24. Po ashtu, nuk është kontestuese se në të njëjtin oborr të shtëpisë ka jetuar vëllai tjetër G.K., në një shtëpi tjetër, dhe se natën kritike askush nuk ka hyrë në shtëpi deri të nesërmen kur motra e të dënuarit, hyn në shtëpi nëpërmes një dritareje nga pjesa e prapme duke e thyer pasi që nuk ka mundur të futet në shtëpi, e cila ishte e mbyllur. Pasi që S.-motra e të dënuarit hyn në shtëpi me dhunë, e gjen tani të ndjerin I.K. të vdekur në dhomën e tij të fjetjes, përderisa i dënuari thotë se ka dëgjuar të shtëna dhe për këtë arsye është mbyllur në shtëpi dhe pas një kohe ka vërejtur se gjyshi është i vdekur, mirëpo nuk mund të jep shpjegim se çka ka ndodhur me “të shtënat “ dhe me personat të cilët i kanë shkaktuar këto të shtëna. Po ashtu, kjo gjykatë gjen se nuk është kontestues fakti se i dënuari, e duke u bazuar edhe në ekspertizën psikiatrike, ka vepruar në gjendje të aftësisë, esencialisht të zvogëluar mendore, dhe se i njëjti edhe para kryerjes së veprës penale, ka pasur probleme shëndetësore, të kësaj natyre dhe se gjatë procedurës penale, fillimisht mohon në tërësi kryerjen e veprës penale, ndërkaq në shqyrtim gjyqësor, deklaron se nuk e din se çka ka ndodhur natën kritike dhe nuk jap asnjë shpjegim. Nga shkresat e çështjes, po ashtu, del fakti jokontestues se tani i ndjeri I.K.-gjyshi i të dënuarit kishte marrëdhënie të mira me tre fëmijët e djalit të tij të ndjerë, Sh., S. dhe G. dhe se së bashku me bashkëshorten e tij të ndjerë, i kishte rritur fëmijët, të cilët kishin mbetur pa kujdesin prindëror. Po ashtu, nuk është kontestues fakti se natën kritike, i ndjeri ka pësuar tri lëndime të rënda me mjet të fortë në kokë, të cilat edhe kanë shkaktuar vdekjen e tij e duke u bazuar në raportin e obduksionit të ekspertizës mjeko-ligjore, ndërsa nga ekspertiza e ekspertëve të psikiatrisë është vërtetuar se i dënuari ka vepruar në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar mendore.

Nga shkresat e çështjes nuk është kontestuese se i dënuari ka qenë i vetmi person i cili ka qenë me të ndjerin dhe se nuk ka prova se në shtëpi është depërtuar me dhunë, sepse e tërë shtëpia ishte e mbyllur dhe nuk kishte shenja të thyerjes eventuale. Fakti se i dënuari ishte vetëm me të ndjerin dhe se askush nuk kishte dëgjuar të shtëna e as nuk kishte ndonjë raportim të shtënave eventuale natën kritike si dhe fakti se dëshmitarja S. - motra e të dënuarit natën kritike e gjen shtëpinë të mbyllur dhe se kurrsesi nuk mund të hyn në shtëpi deri të nesërmen në mëngjes kur edhe me ndihmën e vëllait, G., me shkallë në katin e dytë e thyen xhamin edhe hyn në shtëpi, tregon se i dënuari ka qenë personi i vetëm, i cili kishte qëndruar me të ndjerin.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme ligjore përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal si dhe vlerësimin e rrethanave të cilat kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi e të cilin arsyetim e pranon edhe Gjykata e Apelit si të drejtë.

Nga të gjitha këto dhe nga gjendja drejtë e vërtetuar faktike, drejt është aplikuar ligji penal kur i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.3 të KPK-së.

Nga të gjitha që u tha më lartë, kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 437 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.13/2018, më datë 16.4.2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta